


Tregtia e jashtme e mallrave

Tetor 2022

Tiranë, më 17 Nëntor 2022: Në Tetor 2022 eksportet e mallrave arritën vlerën 38 mld lekë, duke u rritur me 12,5 %, në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë dhe duke u ulur me 0,8 %, në krahasim me Shtator 2022. Importet e mallrave arritën vlerën 83 mld lekë, duke u rritur me 8,6 %, në krahasim me një vit më parë dhe duke u ulur me 5,3 %, në krahasim me Shtator 2022. Defiçiti tregtar i këtij muaji është 45 mld lekë, duke u rritur me 5,5 %, krahasuar me Tetor 2021 dhe duke u ulur me 8,7 %, në krahasim me Shtator 2022.

Fig. 1 Ndryshimi vjetor në Tregtinë e mallrave (%)




Në këtë dhjetëmujorë eksportet e mallrave arritën vlerën 404 mld lekë, duke u rritur me 35,0 %, ndërkohë importet e mallrave arritën vlerën 778 mld lekë, duke u rritur me 23,1 %, krahasuar me një vit më parë. Defiçiti tregtar arriti vlerën 374 mld lekë, duke u rritur me 12,4 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të 2021.

Kontributi i grupeve kryesore në ndryshimin vjetor të eksporteve:

Gjatë muajit Tetor 2022, në rritjen e eksporteve prej 12,5 %, pozitivisht kanë ndikuar grupet: "Tekstile dhe këpucë" me +6,9 pikë përqindje, "Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi" me +2,8 pikë përqindje dhe "Minerale, lëndë djegëse dhe energji elektrike" me +2,3 pikë përqindje. Ndërsa negativisht ka ndikuar grupi: "Materiale ndërtimi dhe metale" me -3,2 pikë përqindje.

Fig.2 Kontributi i grupeve në ndryshimin vjetor të eksporteve, Tetor 2022




Eksportet, gjatë këtij dhjetëmujori janë rritur me 35,0 %, krahasuar me një vit më parë. Grupet që kanë ndikuar pozitivisht në rritjen vjetore të eksporteve, janë: “Minerale, lëndë djegëse dhe energji elektrike” me +10,1 pikë përqindje, “Materiale ndërtimi dhe metale” me +9,3 pikë përqindje, dhe “Tekstile dhe këpucë” me 6,6 pikë përqindje.

Kontributi i grupeve kryesore në ndryshimin vjetor të importeve:

Gjatë muajit Tetor 2022, në rritjen e importeve prej 8,6 %, krahasuar me Tetor 2021, kanë ndikuar pozitivisht grupet: “Minerale, lëndë djegëse dhe energji elektrike” me +5,8 pikë përqindje, “Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi” me +2,3 pikë përqindje, dhe “Tekstile dhe këpucë” me +1,0 pikë përqindje . Ndërsa negativisht kanë ndikuar grupet: “Produkte kimike dhe plastike” me -0,9 pikë përqindje, “Materiale ndërtimi dhe metale” me -0,7 pikë përqindje dhe “Prodhime druri dhe letre” me -0,1 pikë përqindje.

Fig.3 Kontributi i grupeve në ndryshimin vjetor të importeve, Tetor 2022



Si dhjetëmujorë, importet janë rritur me 23,1 %, krahasuar me dhjetëmujorin e parë 2021. Grupet që kanë ndikuar pozitivisht në rritjen vjetore të importeve, janë: “Minerale, lëndë djegëse dhe energji elektrike” me +10,2 pikë përqindje, “Materiale ndërtimi dhe metale” me +4,1 pikë përqindje dhe “ Ushqime, pije, duhan” me +3,1 pikë përqindje.

Ecuria e tregtisë së mallrave sipas vendeve partnere


Në muajin Tetor 2022, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të eksporteve, në krahasim me Tetor 2021 janë: Itali (20,3 %), Gjermani (34,4 %) dhe Maqedoni (3,5 %). Ndërsa vendet me të cilat eksportet kanë pasur uljen më të madhe, janë: Kosova (13,8 %) ,Spanja (13,4 %) dhe Greqia (16,9 %).

Gjatë këtij dhjetëmujori vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të eksporteve, në krahasim me një vit më parë, janë: Itali (42,1 %), Gjermani (74,4 %) dhe Greqia (21,1 %). Ndërsa vendet me të cilat eksportet kanë pasur uljen më të madhe, janë: Kosova (0,03 %) dhe Spanja (15,1 %) .

Në muajin Tetor 2022, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të importeve, në krahasim me Tetor 2021 janë: Turqia (24,7 %), Kina (28,0 %) dhe Spanja (53,5 %). Ndërsa vendet me të cilat importet kanë pasur uljen më të madhe, janë: Italia (1,4 %), Greqia (4,2 %) dhe Gjermania (3,7 %).

Gjatë këtij dhjetëmujori, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të importeve, në krahasim me një vit më parë, janë: Italia (9,0 %), Turqia (39,9 %) dhe Greqia (28,4 %). Ndërsa vendet me të cilat importet kanë pasur uljen më të madhe janë: SHBA (14,4 %), Rusia (15,2 %) dhe Zvicra (27,2 %).

Fig. 4 Tregtia e jashtme e mallrave sipas disa vendeve të BE-së, Tetor 2022



Shkëmbimet tregtare me vendet e BE-së zënë 60,2 %, të gjithë tregtisë. Në Tetor 2022, eksportet drejt vendeve të BE-së zënë 76,9 % të eksporteve gjithsej dhe importet nga vendet e BE-së zënë 52,6 % të importeve gjithsej. Partnerët kryesorë tregtarë janë: Italia (29,6 %), Turqia (8,2 %), Greqia (6,7 %) dhe Kina (6,3 %).

Shkëmbimet tregtare, për dhjetëmujorin 2022, me vendet e BE-së zënë 59,6 % të gjithë tregtisë. Në periudhën Janar – Tetor 2022, eksportet drejt vendeve të BE-së zënë 73,9 % të eksporteve gjithsej dhe importet nga vendet e BE-së zënë 52,2 % të importeve gjithsej. Partnerët kryesorë tregtarë janë: Italia (29,4 %), Turqia (8,4 %), Greqia (7,2 %) dhe Gjermania (6,5 %).

Tab. 1 Qarkullimi i mallrave, Tetor 2022

Vitet	Muajt	Eksporte (mld lekë)	Ndryshimi Vjetor (%)	Importe (mld lekë)	Ndryshimi Vjetor (%)	Bilanci Tregtar (mld lekë)	Mbulimi (%)
2000		37	-23,5	157	-1,5	-120	23,6
2001		44	19,1	190	21,0	-146	23,2
2002		47	7,7	210	10,6	-163	22,6
2003		54	14,7	226	7,4	-172	24,1
2004		62	14,0	236	4,5	-174	26,3
2005		66	6,0	262	11,1	-196	25,1
2006		77	17,6	299	14,1	-222	25,9
2007		97	25,5	376	25,8	-279	25,8
2008		113	15,8	440	16,9	-327	25,6
2009		105	-7,2	429	-2,5	-324	24,4
2010		162	54,6	478	11,4	-316	33,8
2011		197	21,9	544	13,9	-347	36,2
2012		213	8,2	528	-2,9	-315	40,3
2013		246	15,7	517	-2,1	-271	47,6
2014		256	3,8	552	6,7	-296	46,3
2015		243	-4,9	545	-1,4	-302	44,7
2016		243	0,1	579	6,4	-336	42,0
2017		273	12,1	626	8,1	-353	43,6
2018		310	13,7	641	2,4	-331	48,4
2019		299	-3,8	649	1,2	-350	46,0
2021		272	-9,0	605	-6,8	-333	44,9
2019	01 - 19	22	-7,3	42	-6,2	-20	51,9
	02 - 19	23	-5,3	50	8,5	-27	45,4
	03 - 19	28	2,7	56	1,4	-28	49,6
	04 - 19	27	0,1	57	8,9	-30	46,7
	05 - 19	28	-8,0	59	4,0	-31	47,0
	06 - 19	26	-4,1	53	-1,4	-28	47,9
	07 - 19	28	3,7	60	2,7	-32	46,4
	08 - 19	20	-1,8	52	7,1	-32	38,8
	09 - 19	25	5,0	52	-14,2	-27	47,8
	10 - 19	27	-10,2	59	1,8	-32	45,6
	Janar - Tetor 19	252	-3,6	541	2,9	-288	46,6
2020	01 - 20	23	5,3	42	-0,4	-19	54,9
	02 - 20	25	10,6	52	3,9	-27	48,3
	03 - 20	18	-36,0	44	-20,8	-27	40,1
	04 - 20	15	-44,2	36	-36,4	-21	41,0
	05 - 20	22	-22,5	45	-24,2	-23	48,1
	06 - 20	23	-9,6	52	-2,4	-29	44,3
	07 - 20	25	-11,5	57	-5,0	-32	43,3
	08 - 20	19	-3,4	48	-6,7	-29	40,2
	09 - 20	25	-1,2	52	-1,8	-27	48,2
	10 - 20	27	-0,5	59	0,1	-32	45,3
	Janar - Tetor 20	222	-12,2	488	-9,7	-267	45,4
2021	01 - 21	24	3,1	45	8,4	-22	52,3
	02 - 21	25	-0,9	52	0,9	-27	47,4
	03 - 21	32	78,1	64	45,3	-33	49,2
	04 - 21	29	92,3	63	72,9	-34	45,6
	05 - 21	33	52,7	62	38,4	-29	53,0
	06 - 21	35	50,8	67	28,9	-32	51,9
	07 - 21	32	30,6	72	26,1	-39	44,8
	08 - 21	24	22,5	61	26,2	-37	39,0
	09 - 21	33	43,3	69	32,4	-36	48,0
	10 - 21	34	26,3	77	29,2	-43	44,3
	Janar - Tetor 21	300	35,2	632	29,5	-333	47,4
2022	01 - 22	35	47,5	55	21,1	-20	63,6
	02 - 22	37	50,5	69	31,5	-31	54,3
	03 - 22	48	50,4	84	29,7	-36	57,1
	04 - 22	42	46,6	78	23,7	-36	54,0
	05 - 22	45	36,8	80	28,6	-35	56,4
	06 - 22	46	32,2	81	20,8	-35	56,8
	07 - 22	39	23,0	82	14,1	-42	48,3
	08 - 22	35	48,1	80	30,8	-44	44,2
	09 - 22	39	16,3	88	27,4	-49	43,8
	10 - 22	38	12,5	83	8,6	-45	45,9
	Janar - Tetor 22	404	35,0	778	23,1	-374	52,0

Tab. 2 Tregtia e jashtme e mallrave sipas vendeve partnere (milionë lekë), Tetor 2022

	Eksporte				Importe			
	Tetor 2021	Tetor 2022	Jan, - Tetor 2021	Jan, - Tetor 2022	Tetor 2021	Tetor 2022	Jan, - Tetor 2021	Jan, - Tetor 2022
Vendet e BE-së	24.950	29.380	215.640	298.917	41.475	43.819	343.856	406.061
Austri	297	491	2.146	4.309	613	502	5.610	5.650
Gjermani	1.758	2.363	16.290	28.409	5.036	4.850	45.464	48.626
Greqi	2.107	1.752	17.607	21.330	6.726	6.445	49.492	63.572
Itali	14.475	17.407	125.355	178.139	18.821	18.550	155.556	169.548
Spanjë	2.350	2.035	19.883	16.871	1.135	1.741	9.367	13.605
Kroaci	237	308	2.226	6.173	603	853	6.348	8.346
Të tjera të BE-së	3.725	5.024	32.133	43.685	8.541	10.878	72.020	96.715
Mbretëri e Bashkuar	122	260	739	1.810	818	573	5.308	6.269
Kinë	963	390	7.259	8.292	5.639	7.219	53.290	62.054
Kosovë	3.627	3.126	30.963	30.953	1.317	1.504	10.634	13.288
Maqedonia e Veriut	1.194	1.236	10.390	13.890	1.312	955	10.497	12.873
Rusi	1	18	9	43	766	1.120	11.317	9.601
SHBA	366	800	3.664	12.066	1.075	1.287	13.107	11.223
Turqi	350	442	4.586	5.250	7.651	9.541	67.436	94.345
Ukrainë	20	15	274	460	207	285	2.783	3.485
Zvicër	108	96	2.071	2.645	759	593	8.721	6.348
Të tjera	2.260	2.448	23.967	30.127	15.692	16.394	105.407	152.924
Gjithsej	33.962	38.211	299.561	404.452	76.709	83.290	632.356	778.470

Tab. 3 Tregtia e jashtme sipas grup mallrave (milionë lekë), Tetor 2022

Grup-mallrat	Eksporte				Importe			
	Tetor 2021	Tetor 2022	Jan, - Tetor 2021	Jan, - Tetor 2022	Tetor 2021	Tetor 2022	Jan, - Tetor 2021	Jan, - Tetor 2022
Gjithsej	33.962	38.211	299.561	404.452	76.709	83.290	632.356	778.470
Ushqime, pije, duhan	4.171	4.592	35.896	41.178	11.364	11.862	105.482	125.282
Minerale, lëndë djegëse, en,el,	5.623	6.388	56.595	86.893	11.352	15.767	69.858	134.603
Produkte kimike dhe plastike	964	1.332	8.515	15.228	10.531	9.845	92.695	96.801
Lëkurë dhe artikujt prej tyre	231	260	1.727	2.369	1.401	1.609	12.014	14.370
Prodhime druri dhe letre	1.082	1.262	8.079	11.807	2.990	2.940	22.996	29.318
Tekstile dhe këpucë	9.825	12.170	91.780	111.678	9.245	10.017	73.325	84.380
Materiale ndërtimi dhe metale	8.368	7.266	64.722	92.559	11.776	11.257	89.239	115.136
Makinëri, pajisje dhe pj, këmb,	2.792	3.729	23.607	32.325	15.177	16.942	138.968	150.393
Të tjera	905	1.211	8.640	10.417	2.873	3.050	27.780	28.187

Tab.4 Të dhënat progresive të eksporteve sipas grup mallrave dhe partnerëve kryesorë (milione lekë), Tetor 2022

	Itali		Kosovë		Gjermani		Greqi	
	2021	2022	2021	2022	2021	2022	2021	2022
Gjithsej	125.355	178.139	30.963	30.953	16.290	28.409	17.607	21.330
Ushqim. pije duhan	9.085	9.388	3.711	4.475	1.328	1.464	3.159	3.304
Minerale. lëndë djegëse. energji elektrike	1.489	17.688	6.971	4.702	4.329	16.130	6.215	3.245
Produkte kimike dhe plastike	2.488	4.137	2.603	3.428	60	53	627	3.042
Lëkurë dhe artikuj prej lëkure	1.512	2.170	14	12	37	11	13	33
Prodhime druri dhe letre	5.033	7.123	742	1.243	211	267	1.166	1.723
Tekstile dhe këpucë	72.004	87.296	142	148	6.185	6.809	4.028	4.689
Materiale ndërtimi dhe metale	18.023	28.977	14.336	14.116	1.950	1.047	1.882	4.495
Makineri. pajisje dhe pjesë këmbimi	11.693	16.455	1.237	1.503	1.839	2.215	76	116
Të tjera	4.028	4.906	1.208	1.327	351	413	442	683

Tab.5 Të dhënat progresive të importeve sipas grup mallrave dhe partnerëve kryesorë (milione lekë), Tetor 2022

	Itali		Turqi		Kinë		Greqi	
	2021	2022	2021	2022	2021	2022	2021	2022
Gjithsej	155.556	169.548	67.436	94.345	53.290	62.054	49.492	63.572
Ushqim. pije duhan	19.924	23.833	5.629	5.229	816	1.235	13.525	15.386
Minerale. lëndë djegëse. energji elektrike	8.844	3.585	4.278	8.393	11	6	8.512	18.306
Produkte kimike dhe plastike	19.370	20.857	8.933	10.400	7.304	6.187	7.736	8.354
Lëkurë dhe artikuj prej lëkure	9.820	11.336	352	468	604	793	28	41
Prodhime druri dhe letre	5.351	6.397	2.853	4.978	607	1.034	3.335	4.004
Tekstile dhe këpucë	34.577	41.013	15.504	15.745	9.602	10.427	2.818	3.645
Materiale ndërtimi dhe metale	20.467	22.119	17.174	34.960	4.525	7.176	9.220	8.609
Makineri. pajisje dhe pjesë këmbimi	31.636	33.984	8.737	9.896	24.696	29.204	2.819	3.874
Të tjera	5.566	6.425	3.975	4.276	5.125	5.992	1.498	1.352

Metodologjia

Tregtia e Jashtme e mallrave është një publikim periodik mujor që paraqet tregtinë e mallrave të Shqipërisë me vendet e tjera të botës, Të dhënat e përpunuara nga INSTAT për këtë publikim janë të dhëna administrative të cilat merren nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave,

Definicionet:

Eksportet janë në përgjithësi mallra të destinuara tek një vend i tretë, të vendosura nën regjimin doganor, në përpunimin pasiv ose të riekportuar pas përpunimit aktiv,

Vlera F,O,B: Është vlera e mallrave të eksportuara deri në kufirin e vendit eksportues, pra përfshin koston e mallrave të eksportuara dhe shpenzimet deri në kufi të vendit eksportues,

Importet janë në përgjithësi mallra që vinë nga një vend i tretë, të vendosura direkt në qarkullim të lirë ose që qëndrojnë në magazinat e ruajtjes nën procedurat doganore të lejitimit për qarkullim të lirë, për përpunim aktiv ose për përpunim nën kontrollin doganor,

Vlera C,I,F: Është vlera e mallrave të importuara dërguar deri në kufirin e vendit importues, pra përfshin koston e mallit edhe shpenzimet e transportit dhe sigurimit deri në kufirin e vendit që importon mallrat,

Nomenklatura e Kombinuar (NK) është një nomenklaturë mallrash e përdorur për statistikat e tregtisë ndërkombëtare të mallrave dhe për tarifatat doganore,

<http://www.instat.gov.al/al/metodologji/klasifikime-nomenklatura.aspx>;

Vendet anëtare të Bashkimit Evropian: Belgjikë, Gjermani, Francë, Itali, Luksemburg, Holandë, Danimarkë, Irlandë, Greqi, Spanjë, Portugali, Austri, Finlandë, Suedi, Qipro, Çeki, Estoni, Hungari, Letoni, Lituani, Maltë, Poloni, Sllovaki, Slloveni, Bullgari, Rumani, Kroaci,

Shpjegimi i simboleve

(0) vlerë më e vogël se gjysma e njësisë matëse

(-) pa vlerë

(÷) deri